



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS  
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 18 Prot.

Tiranë, më datë 15.01.2024

VENDIM  
Nr. 16, datë 15.01.2024

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 15.01.2024:

VENDOSI:

- Shtyrje vendimmarrje e kërkesës për legalizimin e “Ndërtimit informal shtesë anësore e një objekti 1 katësh, Gjirokastrë” me vetëdeklarues **Znj. Ervehe Lumturi Lekloti**, ndodhur në Zonën e Mbrojtur të qytetit të Gjirokastrës, në lagjen Dunavat, Bashkia Gjirokastrë, me argumentin;
  - Të plotësohet kërkesa me material fotografik ku të qartësohet pozicioni i objektit në lidhje me kontekstin urban ku ndodhet.
- Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi;
- Kundër këtij vendimi mund të ushtrohet ankimi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR  
Klesta QIRICI

